



MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

MINISTARSTVO ZA KULTURU, OMLADINU I SPORTA/ MINISTRY OF CULTURE YOUTH AND SPORTS

DIVIZIONI I BURIMEVE NJERËZORE/ DIVISION OF HUMAN RESOURCES/ DIVIZIJA LJUDSKIH IZVORA

Bazuar , në Nenin 67 dhe 68 të Ligjit për Zyrtarët Publik të Republikës së Kosovës Nr.06/L-114, Ligjin për Institucionet e Kulturës, Ligji Nr.2004/22, për Kinematografinë, Statutin Qendres Kinematografike të Kosovës dhe Udhëzimin Administrativ (MPMS) Nr.07/2017, për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit shpall :

KONKURS

Titulli i punës: Drejtor

Institucioni: Qendra Kinematografike e Kosovës-QKK

Kategoria funksionale : Paga Fikse

Numri i referencës: RN00010824

Kodi: RPC0004486

I përgjigjet: Këshillit Drejtues të Qendrës Kinematografike të Kosovës

Vendi: Prishtinë

Detyrat dhe përgjegjësitë: Drejtori i Qendrës Kinematografike të Kosovës ka detyrimet, autorizimet dhe përgjegjësitë e ngarkuara me ligj, me statutin e QKK dhe me vendimet e Këshillit Drejtues:

1. Përcakton politikat operacionale, për përmbushjen e detyrave të Qendrës Kinematografike të Kosovës dhe të vendimeve të Këshillit Drejtues;
2. Organizon punët e përditshme si dhe motivon, mbikëqyr e vlerëson punën e personelit; bënë pranimin e punonjësve, duke zbatuar procedurën e konkursit, cakton punët dhe përgjegjësitë e punonjësve dhe ka autorizimet tjera, të punëdhënësit;
3. Kujdeset për kushtet e punës dhe për trajnimin e personelit, lidhur me aftësitë e menaxhimit dhe për kryerjen me efektivitet të përgjegjësive të ngarkuara;
4. Harton projekt buxhetin e QKK-së;
5. Propozon organogramin;
6. Përgatitë raportet javore për QKK-në;

7. Përfaqëson Qendrën Kinematografike të Kosovës dhe është përgjegjës, për ecurinë e veprimtarisë së QKK-së, në përputhje me ligjin;
8. Përgatitë mbledhjet dhe materialet për mbledhje të Këshillit Drejtues dhe harton aktet e vendimet tjera, që janë në përgjegjësi të QKK-së, përgatitë raportet vjetore të QKK;
9. Vepron për mbajtjen e raporteve efektive, e korrekte, me Ministrinë e Kulturës e institucionet tjera, me subjektet që merren me kinematografi, me shoqatat profesionale të krijuesve, me partnerë homologë;
10. Propozon juritë profesionale, për përzgjedhjen e projekteve filmike për subvencionim, cakton masën e shpërblimit, për punën e anëtarëve të Këshillit Drejtues, të jurive, të komisionit të vizionimit.

Kërkesat e përgjithshme për pranimin e zyrtarëve publikë

1. Kërkesat e përgjithshme për pranimin e zyrtarëve publikë janë:

- 1.1 të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- 1.2. të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- 1.3. të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- 1.4. të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- 1.5. të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- 1.6. të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji.

Shkollimi i kërkuar, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale:

1. Për Drejtor të Qendrës Kinematografike të Kosovës, emërohet personi që ka arsimim universitar, që ka aftësi organizative e menaxhuese, ose kineast, a krijues me reputacion.
2. Diplomë Universitare, nga Fusha e Artit dhe Kulturës;
3. Duhet të ketë shtatë (7) vite përvojë pune, duke përfshirë katër (4) vite përvojë pune, në vende udhëheqëse;
4. Kandidati duhet të prezantoj projektin për zhvillimin e Qendrës Kinematografike të Kosovës;
5. Aftësi për të udhëhequr një ekip, ose grupe punuese;
6. Aftësi negociuese dhe bindëse, për të përfaqësuar interesat e Institucionit;
7. Të ketë fleksibilitet, në analizimin dhe vlerësimin e çështjeve;
8. Të jetë në gjendje të punojë nën presion, të ketë etikë në punë dhe integritet të lartë pune;

9. Njohja e domosdoshme, të gjuhëve zyrtare të Kosovës në të folur dhe të shkruar;
10. Njohja e gjuhës angleze është e domosdoshme;
11. Njohuri e punës me kompjuter, Word, Excel.
12. Vërtetimi që nuk është nën hetime.

Akte ligjore dhe nënligjore që rregullojnë mandatin: Ligji për Zyrtarët Publik të Republikës së Kosovës Nr.06/L-114, Ligji për Institucionet e Kulturës, Ligji Nr.2004/22, për Kinematografinë, Statuti i Qendrës Kinematografike të Kosovës dhe Udhëzimi Administrativ (MPMS) Nr.07/2017, për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik.

Kohëzgjatja e emërimit: Drejtori emërohet me mandat katër (4) vjeçar me mundësi të rizgjedhjes edhe njëherë radhazi.

Procedurat e konkurrimit: Konkursi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR TË GJITHË KANDIDATËT

Data e njoftimit në webfaqen unike të procedurave të konkurimit <https://konkursi.rks-gov.net> është prej datës 25.01.2023, deri me datë 23.02.2023, ndërsa data e aplikimit është nga data 24.02.2023 deri me datën 10.03.2023.

Përveç web faqes unike të procedurave të konkurimit, konkursi publikohet edhe në Web faqen e MKRS-se.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit , ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil e administratës publike qendrore dhe lokale.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Aplikacionet e dërguara nëpërmjet postës, me pullë postare, në ditën e fundit të shpalljes, konsiderohen të vlefshme. **Paraqitja e kërkesave:** Aplikacioni merret dhe dorëzohet në Zyrën 27 të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Sheshi "Nëna Terezë" Nr. 44. Për informata shtesë kontaktoni në numrin 038211449 dhe 038 211921(apo në ueb-faqen <http://www.mkrs-ks.org/>).